

---

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**

**i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**"Hallakate" SH.P.K**

---

## **AKT THEMELIMI DHE STATUTI**

**i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**"Hallakate" SH.P.K**

---

Sot më 22 shtator 2021, në adresën: Rruga e Kavajës, Kompleksi Sun Tower, Kati 6, Tiranë, Shqipëri, u paraqit:

Ortaku

- **Z. Valon Canhasi**, shtetas Kosovar, lindur në Mitrovicë, më 29/11/1982, banues në Prishtinë, Rruga "B, B2/P5", Prishtinë, Kosovë, identifikuar me numër pasaporte PO1166597, e lëshuar më 13/06/2018, e vlefshme;

të cilët deklarojnë se i pranojnë me vullnetin e tyre të lirë klauzolat dhe dispozitat e parashikuara më poshtë, hartimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë **Hallakate Sh.p.k.** në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Republikës së Shqipërisë ["Ligji i Shoqërive"].

### **TITULLI I**

**EMRI, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI I SHOQËRISË, AKTET**

**NENI 1  
EMRI I SHOQËRISË**

1.1 Emri i shoqërisë është **Hallakate Sh.p.k.**, ["Shoqëria"]

**NENI 2  
SELIA**

- 2.1 Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga e Kavajës, Kompleksi Sun Tower, Kati 6, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë apo të themelojë dhe/ose të mbyllë një degë dhe/ose zyrë përfaqësimi brenda Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

**NENI 3  
KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar kohe.

**NENI 4**  
**OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1 Objekti i Shoqërisë është të ndërmarrë çdo lloj aktiviteti tregtar i lejuar nga ligji i zbatueshëm, duke përfshirë por pa u kufizuar në ofrimin e shërbimeve të Agjencisë Publicitare si dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve të tjera që konsiderohen të ndërlidhura apo ndihmëse për arritjen e objektit të mësipërm. Për më tepër, Shoqëria mund të hyjë në cdo transaksion i cili konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të mësipërm.

**NENI 5**  
**AKTET E SHOQËRISË**

- 5.1 Të gjitha dokumentet e nxjerra nga Shoqëria dhe që i drejtohen palëve të treta, si letra, fatura, njoftime, lajmërimet etj, duhet të përbajnë emrin e shoqërisë dhe fjalët "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet "SH.P.K." dhe numrin unik të identifikimit (NUIS).

**TITULLI II**

**KAPITALI, CERTIFIKATA E KUOTËS**

**ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

**NENI 6**  
**KAPITALI I SHOQËRISË**

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë, që konsiston në 1 ( një) kuotë, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar, ndahet si vijon

- 1 (një) kuotë e barabartë me 100% të kapitalit, me vlerë 100 (njëind) Lekë të zotëruara nga ortaku Valon Canhasi.

- 6.2 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar tërësisht nga Ortaku.

- 6.3 Kuota e kapitalit të Shoqërisë mund të transferohet vetëm në bazë të vendimit unanim të Asamblesë së Përgjithshme për këtë çështje.

**NENI 7**  
**ÇERTIFIKATA E KUOTËS**

- 7.1 Ortaku ka të drejtë të marrë një certifikatë për kuotën që ai ka. Kjo certifikatë nuk duhet të konsiderohet si sigurim dhe nuk mund t'a shesë apo t'a tregtojë në bursë.

**NENI 8**  
**TRANSFERIMI I KUOTAVE**

- 8.1 Kuotat mund të transferohen *causa mortis* ose *inter vivos*. Këto kuota mund t'i transferohen një pale të tretë, që nuk i përket Shoqërisë në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për këtë çështje dhe nëse ky transferim bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Statut.
- 8.2 Cdo transferim i kryer ndaj një personi i cili nuk është ortak në Shoqëri do të lejohet vetëm nesë më parë i është dhënë e drejta ortakut të mbetur të Shoqërisë të blejë një pjesë apo të gjithë kuotën që shitet.
- 8.3 Cdo trasnferim i kuotave i kryer në kundërshtim me parashikimet e këtij Statuti do të konsiderohet nul dhe i pavlefshëm, dhe do të përbëjë shkelje të detyrave të lëna në mirëbesim nga ortaku shkelës, i cili do të mbajë përgjegjësi në përputhje me Ligjin e Shoqërive.

**NENI 9**  
**ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendsë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit. Kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet më shumë se kufijtë e përcaktuar nga ligji.

**KREU III**

**QEVERTISJA E SHOQËRISË**

**NENI 10**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme përfaqëson organin vendimmarrës të Shoqërisë.
- 10.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, për të dhënë mendimin e tij si dhe për të ushtruar të drejtën e votës në proporcione pjesëmarrjen në kapital.
- 10.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet në mbledhje nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë, me anë të një prokure të posaçme ose të një autorizimi të shkruar. Ortakët nuk mund të përfaqësohen nga Administratori i Shoqërisë.
- 10.4 Ortakët mund të mos japë të drejtën e votës për pjesën e kuotës që ato kanë për të ushtruar në lidhje më pjesën tjeter.
- 10.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjeter brenda vendit apo jashtë shtetit. Ortakët mund të marrin pjesë në këtë mbledhje vetë personalisht ose nëpërmjet mjeteve elektronike si p.sh. video ose konferencë telefonike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të jenë të pranishëm dhe të ndjekin në kohë të gjithë diskutimin. Ortaku që merr pjesë nëpërmjet një video konference apo mjeteve të tjera elektronike, mund të votojë nëpërmjet një numri PIN, i cili duhet të komunikohet së bashku me thirrjen për Asamblenë e Përgjithshme. Asambleja e

Përgjithshme, do të konsiderohet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllimin e drejtimit të mbledhjes dhe të hartimit të procesverbalit të mbledhjes në regjistrin përkatës.

- 10.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/Këshilli i Administrimit ose nga ortaku (ët) që përfaqëson të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret me anë të një njoftimi të dërguar më postë të regjistruar me lajmërim marrje apo me e-mail (me kushtin që këto njoftime nuk do të konsiderohen të vlefshme nëse nuk ju janë dërguar të gjithë ortakëve në adresat e dhëna Shoqërisë nëpërmjet postës elektronike), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së parashikuar. Thirrja për mbledhje duhet të përbajë çështjet e rendit të ditës, vendin e mbledhjes, ditën dhe orën e mbledhjes për thirrjen e parë dhe të dytë.
- 10.7 Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur rregullisht, pa patur parasysh formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në të dhe bien dakort për rendin e ditës.
- 10.8 Asambleja e Përgjithshme kryesoitet nga Administratori i Shoqërisë. Asambleja në çdo mbledhje emëron nga të pranishmit një Sekretar të mbledhjes.
- 10.9 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë në formë të shkruar dhe të firmosën nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes. Me kërkesë të ortakëve, vendimi do të përbajë çdo deklaratë të tyre.
- 10.10 Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e mbylljes së vitit finanziar.
- 10.11 Asambleja e Përgjithshme, në rast se votimi kérkon një shumicë të thjeshtë votash, ai është i vlefshëm kur votojnë ortakët me të drejtë vote që përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjetë përlind) të kapitalit të Shoqërisë, personalisht ose me përfaqësim, duke përjashtuar rastet e parashikuara në nenin 9.12. Nëse nuk arrihet një kuorum i tillë, Asambleja e Përgjithshme mblidhet me një thirrje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga thirrja e parë.
- 10.12 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve të cilat kérkojnë një shumicë të kualifikuar të votave, merr vendime me shumicën e 3/4 të votave vetëm në rast se marrin pjesë ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit, për çështjet që vijojnë: (i) ndryshimi i këtij Statuti; (ii) zmadhim ose zvogëlim të kapitalit themeltar; (iii) shpërndarjen e fitimeve; (iv) riorganizimin ose likujdimin e Shoqërisë.
- 10.13 Në rast se Shoqëria konsiston në një ortak të vetëm, të drejtat dhe detyrimet që i takojnë Asamblesë së Përgjithshme, do të kryhen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e ortakut të vetëm do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve të Shoqërisë, të dhënat të cilat mund të shtohen apo fshihen. Çdo vendim i paregjistruar në regjistrin e vendimeve të shoqërisë është nul.

**NENI 11**  
**TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE**

11.1 Ortakët i ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me ligjin dhe statutin, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- të marrë pjesë në administrimin e Shoqërisë në përputhje me parashikimet e ligjit, Aktin e Themelimit dhe Statutin;
- të kërkojnë dhe të marrin të dhëna që lidhen me situatën dhe aktivitetin e shoqërisë dhe të marrin çdo dokument të hartuar nga Shoqëria (pasqyra financiare, libra llogarie etj.);
- të paraqesin propozime dhe kërkesa të shkruara në Asamblenë e Përgjithshme dhe organe të tjera të Shoqërisë;
- të drejta të tjera të dhëna nga ligji dhe akti i themelimit.

11.2 Detyrimet e ortakëve janë si vijon:

- të paguajnë tërësisht kuotat e tyre të nënshkruara dhe çdo kuotë shtesë, në përputhje me këtë Statut dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
- të marrë pjesë në administrimin e Shoqërisë nëpërmjet organeve të themeluara në bazë të aktit të themelimit;
- të kryejë detyrimet që i janë caktuar nga organet e Shoqërisë për realizimin e objektivave të Shoqërisë.

**NENI 12**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

12.1 Shoqëria do të administrohet nga një Administrator të vetëm, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Administratori mund të rizgjidhet dhe të lirohet nga detyra nga Asambleja e Përgjithshme në çdo kohë.

12.2 Administratorit i është dhënë fuqi e plotë lidhur me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë gjithë veprimet e nevojshme për përbushjen e objektit të Shoqërisë, përvèç detyrave të parashikuara nga ligji ose që ligji ja atribuon Asamblesë së Përgjithshme.

12.3 Administratori është përgjegjës për çdo veprim të kryer gjatë administrit të Shoqërisë. Administratori mund t'i japë palëve të treta fuqi për të kryer veprime të caktuara, që lidhen me administrimin e Shoqërisë.

12.4 Në çdo rast, Administratori duhet të veprojë në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast të një konflikti interesash, Administratori i përfshirë në të duhet të njoftojë menjëherë ortakët dhe duhet të mos kryejë asnjë veprim që lidhet me konfliktin e interesit, deri në marrjen e instruksioneve nga Asambleja e Përgjithshme.

12.7 Administratori i parë i Shoqërisë është **Z. Valon Canhasi**, banues në Prishtinë, Rruga "B, B2/P5", identifikuar me numër pasaporte PO1166597, e lëshuar më 13/06/2018, e vlefshme.

12.8 Specimeni i nënshkrimit të Administratorit të Vetëm tregohet më poshtë:

VALOM CAHASI
V. Cel

**NENI 13**  
**SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORËVE**

13.1 Pagesat e Administratorit përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

**NENI 14**  
**LARGIMI I ADMINISTRATORIT**

14.1 Detyra e Administratorit përfundon në rastet vijuese:

- (a) sipas parashikimit të ligjit;
- (b) kur ka paaftësi paguese;
- (c) është apo mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- (d) jep dorëheqjen nga detyra duke njofuar për këtë Shoqërinë;
- (e) është zhdukur nga zyra pa dhënë arsy për më shumë se 6 (gjashtë) muaj të njëpasnjëshëm dhe Asambleja e Përgjithshme vendos për largimin nga detyra;
- (f) kur përfundon mandati i tij dhe Asambleja e Përgjithshme nuk e riemëron atë.

**KREU IV**

**AUDITIMI FINANCIAR I SHOQERISE**

**VITI FINANCIAR, PASQYRAT FINANCIARE VJETORE, DIVIDENDI**

**NENI 15**  
**AUDITI FINANCIAR**

15.1 Auditimi Financiar i Shoqërisë, nëse do të përbushen kushtet ligjore, do të kryhet nga Auditues Ligjorë, sipas ligjeve Shqiptare në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te caktojë një ose më shume Auditues Ligjorë.

**NENI 16**  
**VITI FINANCIAR**

16.1 Viti finansiar i Shoqërisë fillon në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor të çdo viti.

**NENI 17**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

- 17.1 Bilanci vjetor, tre apo gjashtë mujor, pasqyrat financiare, inventari dhe raportet e Administratorit/Këshillit të Administrimit si dhe Ekspertëve Kontabël, paraqiten në Asamblenë e Përgjithshme për pranim dhe miratim.
- 17.2 Dokumentet në lidhje me vitin finansiar, duhet te miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbarimi i vitit finansiar.

**NENI 18**  
**DIVIDENDI**

- 18.1 Pas miratimit të Pasqyrave Financiare Vjetore apo periodike (si 3 apo 6 mujore), Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për shpërndarjen e dividendit tek ortaket e Shoqërisë.

**NENI 19**  
**SHPËRNDARJA E FITIMIT NË KAPITALIN E SHOQËRISË**

- 19.1 Administratori/Këshilli i Administrimit me marrjen e vendimit me shumicë të Asamblesë së Përgjithshme dhe duke marrë në konsideratë parimet e përcaktuara në Nenin 14 te Ligjit N. 9901 të datës 14.04.2008 Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare, mund të vendosë që fitimet e pashpërndara ortakëve dhe që nuk kanë ndërmend të shpërndahen si dividend preferencial, apo për ndonjë shumë tjetër si fond rezervë i Shoqërisë, të alokohen në kapitalin e Shoqërisë.

**KREU V**

**RIORGANIZIMI, LIKUIDIMI, LIGJI NË FUQI DHE**

**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

**NENI 20**  
**RIORGANIZIMI DHE LIKUIDIMI**

- 20.1 Në rastin e riorganizimit ose likuidimit, do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë për riorganizimin apo likuidimin e Shoqërisë me një shumicë prej 3/4 e votave të ortakeve të pranishëm në mbledhje. Asambleja konsiderohet e mbledhur rregullisht, nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e të drejtës së votave në total.

**NENI 21**  
**LIGJI NË FUQI**

- 21.1 Shoqëria do të kryej aktivitetet e saj në përputhje të plotë me dispozitat këtij Statuti dhe ligjin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në ketë Statut, do të zbatohet ligji shqiptar në fuqi.

**NENI 22**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 22.1 Çdo mosmarrëveshje midis Shoqërisë dhe ortakut te saj, ose mes ortakut dhe trashëgimtarit, ose ndërmjet tyre dhe/ose Shoqërisë, do të zgjidhet miqësish midis palëve. Nëse një zgjidhje e tillë dështron, autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 23**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

- 23.1 Statuti u hartua në 3 kopje në gjuhën shqipe, u lexua, pranua dhe nënshkrua nga Ortaku më 20.09.2021.

Ortaku i "Hallakate" Sh.P.K.

Z. Valon Canhasi



